



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GRACANICA

Numri i lëndës: 2023:278829

Datë: 04.10.2024

Numri i dokumentit: 06253180

P.nr.192/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me zyrtaren ligjore Blerta Bekteshi, në çështjen penale, kundër të akuzuarit S.N., për shkak të veprës kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së, duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.610/23F, të datës 11.12.2023, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 27.09.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit Avni Namani i akuzuari S.N si dhe e dëmtuara K.N. me datë 27.09.2024, mori dhe publikisht shpalli, dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S.N i biri i, dhe i nënës vajzërisë i lindur më në, me vendbanim në rrugën në fshatin I ri KK, i pa punë, me numër personal, i martuar, me gjendje të dobët ekonomike, sërb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse ekziston dyshimi i bazuar mirë se me datë 28.08.2023, rreth orës 12:12, në Graçanicë, i pandehuri S.N, me dashje ka kanosur seriozisht të dëmtuarën/dëshmitarën, bashkëshorten e tij K. M., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara psai e dëmtuara kishte marrë pa dijeninë e të pandehurit fëmijun e tyre të përbashkët të mitur për të shkuar tek familja e saj, kjo pas mosmarrëveshjes paraprake që kishte pasur me vjehrën e saj dhe të pandehurin lidhur me kujdesin për djalin/nipin e tyre, i pandehuri i dërgon të dëmtuarës Kosovska mesazhe kërcënuese nga numri i tij i telefonit duke iu drejtuar me fjalët: *“ka me ta q... gjakun e kurvës Shqiptare, lëshoje fëmijën në Graçanicë, kurvë, nëse ma prek fëmijën dikush nga minjtë e tu nga morava ki me pa, duart kam me ti pre”* me çka tek e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe rrezikshmërisë personale;

- **me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.2 Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.**

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 46; 49; 50; 51; 52 dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 365, 450, 463 të KPPK-së, të akuzuarin:

EGJYKON

Të akuzuarit: **S.N** i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën verifikuese prej një **(1) viti**, nuk kryen veprë tjetër penale dhe dënohet në shumë prej **400 (katër qind euro) €** të cili dënim është i obliguar që ta paguaj 30 ditë nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara: **K.N** në rrugënnë fshatinKK , lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo – juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP.II.nr.610/23F, të datës 11.12.2023, e ka akuzuar të akuzuarin S.N, për shkak të veprës kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.27.09.2024, ku në seancë kanë qenë të pranishëm Prokurori i shtetit Avni Namani i pandehuri S.N, si dhe e dëmtuara K.M .

Në shqyrtimin fillestar të hapur të mbajtur me dt.27.09.2024, Prokurori i shtetit lexoi aktakuzën, dhe menjëherë të akuzuarit i'u dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet të pafajshëm.

I akuzuari, në shqyrtimin, deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën në tërësi, me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorit të shtetit, gjithashtu ka deklaruar se jamë penduar se çka ka ndodhur.

Prokurori i shtetit, lidhur me panimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi se: Meqë i akuzuari e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nga ana e tij është bërë në përputhje të plotë me dispozitën 242 të KPPK – së, pajtohem plotësisht me panimin e fajësisë të deklaruar nga i akuzuari. I njëjti ka deklaruar që i vjen keq për veprimet e tij.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga i akuzuari gjykata në bazë të nenit 326 par. 1 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, me Aktvendim pranoi panimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe se i akuzuari e ka pranuar fajësinë pa presion dhe me vullnetin e tij të plotë.

Nga thëniet e vet të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e akuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklaratimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit të lartcekur, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale si në hyrje të këtij aktgjykimi, si dhe vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtin pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese se: i pandehuri ishte i sinqertë gjatë shqyrtimit fillestar, se e ka pranuar fajësinë, se pranimi i fajësisë është bërë në fazat fillestare, kërkim falja dhe gjendja ekonomike të vështirë, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqipton dënim me kusht dhe dënim me gjobë.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73 par. 2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj të të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 458 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË /
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL**

P.nr.192/2023, dt. 27.09.2024.

Zyrtarja Ligjore
Blerta Bektashi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Rrustem Begolli

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.